



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 2718/3 Prot.

Tiranë, më 01.04.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1788, datë 31.12.2015.

SHOQËRISË “DEVOLLI HYDROPOWER” SH.A
Aba Business Center, Zyra Nr.1204, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “DEVOLLI HYDROPOWER” sh.a është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1788, datë 31.12.2015, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Moglicë”, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.1202/6, datë 03.08.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.5350/2 Prot, datë 05.11.2020, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1788, datë 31.12.2015, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Moglicë”, Qarku Korçë, sepse lejes minerare i ka mbaruar afati ligjor.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 2, gërma “a” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014, datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1788, datë 31.12.2015, për mineralin Gur Gëlqeror, në objektin “Moglicë”, Qarku Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit **Nr.1788, datë 31.12.2015, për mineralin Gur Gëlqeror në objektin “Moglicë”, Qarku Korçë.**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

